



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2021:214568

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05445709

**C.nr.2034/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, gjyqtari Shaban Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.B. me numër personal .... nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Studio Ligjore & Financiare “Klinaku .....", Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 7,366.95 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë **13.03.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**(Pa shqyrtim kryesor)**

**I. APROVOHET pjesërisht e bazuar** kërkesëpadia e paditësit **A.B. nga Prizreni**, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

**II. DETYROHET** e paditura, që paditësit në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 01.09.2018 e deri më datë 31.12.2020 apo për 26 muaj (çdo muaj shumën prej 96.97 euro, në shkallë prej 35% të pagës bazë – 459 euro në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit) t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej **2.520.44 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 24.09.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

**III. REFUZOHET** e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, përkatësisht shuma prej 4,846.51 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e deri më datë 31.08.2018 për shkak të parashkrimit dhe 01.01.2021 deri me 30.06.2022 për njohjen e 10% të pagës bazë.

**IV. DETYROHET** e paditura, që paditësit, t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi A.B. nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Studio Ligjore & Financiare “Klinaku .....", Prishtinë, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimin e Avansimit në Karrierë dhe Zhvillimit Profesional, me vlerë të kontestit 7,366.95 euro.

Në padi, pala paditëse përmes të autorizuarit të tij ka theksuar se ka të kryer fakultetin e mjekësisë dhe ka marrë Doktor i Mjekësisë dhe është licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, andaj në bazë të kësaj i takon edhe kompensimi për avancimin në karrierë dhe zhvillimit profesional. Gjithashtu ka theksuar se është i punësuar si mësimdhënës për më tepër se 20 vite pranë ShFMU “Luciano Motroni” në Prizren, ku vazhdon të punojë në këtë institucion.

Me parashtresën e datës 16.09.2022 i autorizuari paditëses ka precizuar kërkesëpadinë, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që të detyroj të paditurën Komuna e Prizrenit, që paditëses të ia paguaj shumën prej 7,366.95 euro, respektivisht 35 % të pagës bazë 459 euro, shumën 160.65 euro për çdo muaj, nga 18.04.2017 e deri më datë 31.12.2020 dhe shumën prej 45.9 euro për çdo muaj nga data 01.01.2021 e deri më datë 30.06.2022 apo 10% e pagës bazë 459 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit dhe të detyrohet e paditura që t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditësit se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësi nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësi ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, duke deklaruar se paditësi ka humbur të drejtën për realizimin e kërkesës, pasi që ka kaluar afati 3 vjeçar, ashtu që ka arritur parashkrimi i kërkesës së paditësit. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi A.B. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë ShFMU “Luciano Motroni” në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditësit për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkuar.

Në këtë drejtim, nga kontrata e punës nr. 944/2020 të datës 07.12.2015 e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës, rezulton se kualifikimi i paditësit është kualifikimi universitar, respektivisht i njëjti është Mjek i Përgjithshëm, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 2892 e datës 11 Janar 2011, në emër të paditësit.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit të fakultetit, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 63.68 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga kontrata e punës me numër 944 të datës 07.12.2015 si dhe nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar vetëm shumën prej 63.68 euro, nga gjithsej shuma prej 160.65 euro, ashtu që diferenca e papaguar është shuma prej 96.97 euro sa i takon paditësit. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësja përfiton ngritje prej 35% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 160.65 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 96.97 euro për 26 muaj nga data 01.09.2018 deri më datë 31.12.2020 e në shumë të përgjithshme prej 2,520.44 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 24.09.2021, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 24.09.2021, ndërsa kërkesa e tij ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 deri më datë 31.08.2018. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar në shumën prej 2,731.05 euro. Ndërsa gjykata ka refuzuar shumën prej 1,656.45 euro, pasi që sipas shkresave të lëndës, respektivisht sipas listës së pagës të lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës, gjykata vërtetoi faktin se paditëses në emër të kualifikimit universitar, respektivisht fakulteti i është paguar shuma prej 63.68 euro nga gjithsej shuma e përgjithshme 160.65 euro, e që nga kjo rrjedhë se paditëses i takon kompensimi i diferencës së papaguar, respektivisht shuma prej 96.97 euro e jo shuma prej 160.65 euro siç ka pretenduar paditësi, Ndërsa gjykata ka refuzuar shumën prej 780,30 euro të cilën paditësja e kërkuar që për 11 muaj të vitit 2021 ( nga data 01.01.2021 e deri më 31.12.2021) si dhe për 6 muaj të vitit 2022 ( nga data 01.01.2022 e deri më 30.06.2022) ti paguhet 10% i pagës bazë 459 euro, respektivisht shuma prej 45.90 euro për çdo muaj, pasi që sipas listës së pagës të lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës, rezulton se në emër të kualifikimit paditëses i është paguar shuma prej 63.68 euro, e që në rastin konkret paditëses për periudhën 01.01.2021 e deri më datë 30.06.2022 i është kompensuar shuma prej 10% e pagës bazë që e ka kërkuar, andaj mbi këtë bazë gjykata vendosi sikurse në pikën nën III. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin merititor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve

Numri i lëndës: 2021:214568

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05445709

të procedurës kontestimore, paditëses t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 398 e 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil**  
**C.nr.2034/21, të datës 13.03.2024**

**Gjyqtari**  
**Shaban Shala**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.